



albamedia

Delivering Technology To Your Business

+20 vite ekspertizë dhe përkushtim
në distribucionin e teknologjisë IT

SJELLIM TEKNOLOGJINË E MARKAVE LIDER NË BIZNESIN TUAJ

Albamedia Shpk është një kompani distribucioni në sektorin e teknologjisë së informacionit e themeluar në vitin 2004. Duke ofruar një gamë të gjerë produktesh dhe zgjidhjesh nga markat më të njohura në fushën e IT-së, Albamedia ka fituar reputacion si një partner i besueshëm për një spektër të gjerë klientele në treg, që përfshin dyqanet e retail, ato të specializuara të IT-së, dyqanet online, integrorët, etj.





Si distributor i produkteve të Teknologjisë së Informacionit, misioni ynë është të koordinojmë sa më mirë ekspertizën dhe potencialin e partnerëve tanë me nevojat e klientëve tanë.



MISIONI

Të bëhemi partneri i preferuar dhe afatgjatë i klientëve tanë.

VIZIONI

DISA NGA AVANTAZHET TONA

Besnikëri

Gjatë viteve, kemi përmirësuar aftësitë tona për të reaguar shpejt ndaj kushteve të tregut, duke ruajtur në të njëjtën kohë një fokus të fortë në kënaqësinë e klientit. Kjo na ka mundësuar të përgjigjemi ndaj kërkesave të ndryshme të partnerëve tanë të biznesit me besnikëri dhe duke mbrojtur interesat e tyre.




Shpejtësi

Të vepruarit me shpejtësi dhe efikasitet në përgjigje të kërkesave tuaja, janë të gjitha elemente bazë për një marrëdhënie të suksesshme biznesi dhe për ne, këto janë standardet. Proceset e thjeshta të vendimmarrjes garantojnë ndihmë të shpejtë për pyetje ose zgjidhje të problemeve.

Ekspertizë

Ekipi ynë ka eksperiencë të gjerë në fushën e distribucionit dhe të shitjeve me shumicë. Duke shfrytëzuar përvojën tonë, dhe duke patur marrëdhënie të drejtpërdrejta me vendimmarrësit kryesorë të prodhuesve jemi pozicionuar unikalisht për të ofruar avantazhe të rëndësishme për partnerët tanë të biznesit.



Numrat flasin




+20.000
PRODUKTE



+2.000
KLIENË B2B



+50
MARKA



+20
VITE NË TREG

Ekipi ynë

Reputacioni i një kompanie nuk ndërtohet vetëm mbi produktet dhe shërbimet e saj, por edhe mbi mënyrën se si trajton punonjësit dhe klientët e saj. Për këtë arsye, ne kemi vënë theks të madh në krijimin e një mjedisi pune të këndshëm. Ekipi ynë bashkëpunon me harmoni, duke nxitur një atmosferë të përzemërt dhe duke angazhuar punonjësit në aktivitete grupore brenda dhe jashtë orarit të punës. Kjo jo vetëm që rrit cilësinë e punës, por edhe inkurajon një qasje profesionale, forcon shpirtin e ekipit dhe ndihmon në formimin e lidhjeve ndërmjet anëtarëve të ekipit. Struktura jonë organizative është projektuar për të nxitur autonomi dhe përgjegjësi në ambientin e punës. Kjo reflektohet në hierarkinë e thjeshtë të kompanisë, si dhe në komunikimin e drejtpërdrejtë dhe të hapur ndërmjet punonjësve dhe departamenteve. Besimi që i japim punonjësve tanë luan gjithashtu një rol të rëndësishëm.



Partnerët

Objektivi ynë është të sigurojmë që klientët tanë të përfitojnë nga avantazhet që krijojmë përmes bashkëpunimit të ngushtë me partnerët tanë.

Kjo u mundëson atyre të ofrojnë të njëjtin nivel të forcës dhe besueshmërisë në marrëdhëniet e tyre të biznesit.

brother
at your side

Canon

PaperCut

uniFLOW

tp-link

Aginet

MERCUSYS

UROVO

Newland

DASCOM

ZEBRA

POSBANK

Honeywell

syble

ZIMP
CASH DRAWER

tenable

PICUS

Microsoft

FORTINET

Adobe

vmware

kaspersky

panda

TREND
MICRO

HANNspree

PHILIPS

AOC

Neomounts

gembird

Kingston

SanDisk

cablexpert

energenie

UGREEN

maxell

G&G

blackpoint

tapo

VIGI

kasa
smart

Vlerësimet e standardeve ndërkombëtare



ISO 27001-2013



ISO 9001-2015

ERP

Në vitin 2021, Albamedia ka implementuar Microsoft Dynamics 365 Business Central si sistem të ri ERP që na lejon të lidhemi drejtpërdrejt me sistemet ERP të partnerëve tanë. Kjo bën shkëmbimin e informacionit më të lehtë dhe më efikas.

B2B Commerce

Albamedia i ofron partnerëve të saj të regjistruar një portal shitjesh me shumicë.

Disa nga avantazhet B2B të Albamedias janë:

- ✓ Proces i thjeshtuar i porosive
- ✓ Inventari dhe çmimet në kohë reale
- ✓ Opsione të personalizuar të çmimeve dhe ofertave
- ✓ Përvojë e përmirësuar e përdoruesit
- ✓ Opsione shtesë të filtrimit për produktet
- ✓ Akses 24/7
- ✓ Të dhëna të plota të llogarisë (faturat, porositë, të dhënat e llogarisë si klient etj)
- ✓ Informacion i detajuar i produktit



Microsoft
Dynamics 365

Integrimi i të dhënave

Partnerët tanë të B2B-së, kanë mundësinë të zgjedhin midis dy opsioneve të integrimimit – XLSX/CSV ose REST API/EDI. Këto opsione ndryshojnë në kohën e përditësimit të të dhënave, gjuhën, frekuencën e shkarkimeve dhe funksionalitete të tjera.

Pavarësisht zgjedhjes së modelit të integrimimit, të gjithë partnerët që përdorin platformën tonë të blerjeve marrin automatikisht akses të lirë për të shkarkuar skedarët XLSX/CSV, të cilët përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

- çmimet, gjendja e stokut
- përmasat dhe pesha e produktit
- përshkrimet teknike të produktit
- imazhet
- lista e kategorive
- lista e prodhuesve

Kategoritë e produkteve

Produktet dhe Shërbimet e Albamedia shpk përfshijnë:



Printimi



**Sisteme
PC**



Rrjeti



**Pos &
Auto ID**



Software



**Monitorë &
Zgjidhje Montimi**



**Pajisje
Data Storage**



**Komponentë
Kompjuterik**



**Pajisje
Zyre**



**Pajisje
Smart**



Printimi

brother.
at your side

Canon

PaperCut^P

uniFLOW

Si distributor zyrtar i Brother, Canon, Papercut dhe Uniflow, Albamedia Shpk ofron një gamë të gjerë produktesh dhe zgjidhjesh për printim që varion nga nevojat bazike të printimit në zyrë apo shtëpi, deri te zgjidhjet më komplekse dhe të personalizuar për projekte të mëdha printimi nëpër korporata etj. Përveç ofertës së gjerë të produkteve, Albamedia Shpk ofron gjithashtu edhe konsulencën e duhur dhe mbështetje teknike për të gjithë klientët e saj, duke u siguruar se të gjitha zgjidhjet e printimit funksionojnë në mënyrën më efikase dhe të qëndrueshme.



Sisteme PC

DELL

ASUS

HP

Në Albamedia, ne jemi të përkushtuar të ofrojmë një gamë të gjerë zgjidhjesh kompjuterike për bizneset dhe organizatat, duke u bazuar në eksperiencën tonë të gjatë në distribucionin e teknologjisë së informacionit. Në partneritet me markat më të njohura ndërkombëtare, ne shpërndajmë laptopë, desktopë dhe work-station me performancë të lartë, duke garantuar besueshmëri dhe cilësi të lartë. Gjithashtu, ofrojmë periferikë dhe aksesore për të optimizuar infrastrukturën tuaj kompjuterike. Si lider në distribucionin e IT-së, Albamedia fuqizon bizneset për t'u spikatur në një treg konkurrues.



SHËRBIMET E TRANSFORMIMIT DIGJITAL NGA ALBAMEDIA

Integrim i përsosur i dokumenteve fizike dhe dixhitale me teknologji, zgjidhje dhe shërbime

Shërbimet e Menaxhuara të Printimit (MPS)

Optimizoni Mjedisin tuaj të Printimit për Efikasitet Maksimal

Albamedia, në partneritet me Canon, Brother, Uniflow dhe Papercut ofron Shërbime të Menaxhuara të Printimit (MPS), të krijuara për të përmirësuar infrastrukturën tuaj të printimit. Shërbimet tona sigurojnë që biznesi juaj të përfitojë nga një mjedis printimi i sigurt, i qëndrueshëm dhe i optimizuar, duke ju lejuar të përqendrohni në aktivitetet tuaja kryesore. Pavarësisht nëse implementohet në vend, përmes cloud-it, ose në një konfigurim të përzier, zgjidhjet tona MPS ofrojnë:

- Optimizim i Plotë i Printimit: Kombinimi i teknologjive kryesore të industrisë me shërbime ekspertësh për të menaxhuar dhe mbështetur të gjithë infrastrukturën tuaj të printimit.
- Siguri dhe Përputhshmëri e Shtuar: Siguroni mbrojtjen e të dhënave dhe përputhshmërinë me rregulloret përmes zgjidhjeve tona të sigurta të printimit.
- Efikasitet i Kostos dhe Qëndrueshmëri: Ulni kostot e printimit duke promovuar praktika miqësore me mjedisin.

brother.
at your side

Canon

PaperCut


uniFLOW

Bashkëpunimi në Vendin e Punës

Fuqizoni Bashkëpunimin dhe Optimizoni Menaxhimin e Përmbajtjes


Albamedia ofron zgjidhje të shkallëzuara dhe fleksibile për Bashkëpunimin në Vendin e Punës, të përmirësuara nga zgjidhja e fuqishme Uniflow e Canon, që çon menaxhimin e përmbajtjes dhe dokumenteve të biznesit tuaj në nivelin tjetër. Duke integruar lidhjen e avancuar me cloud, automatizimin e proceseve dhe teknologjitë më të fundit të Canon, ne ju ndihmojmë të optimizoni proceset komplekse të biznesit dhe të përmirësoni bashkëpunimin në të gjithë organizatën tuaj. Zgjidhjet tona përfshijnë:

- Lidhje e Përsosur me Cloud-in: Lidhni dhe menaxhoni përmbajtjen në mënyrë të sigurt nëpërmjet platformave të ndryshme cloud si Google Drive, OneDrive dhe Dropbox, duke mundësuar bashkëpunim të lehtë në distancë.
- Kapje e Avancuar e Dokumenteve dhe Automatizimi i Procesit me Uniflow: Automatizoni kapjen e të dhënave, indeksimin dhe flukset e punës me dokumentet për të rritur efikasitetin dhe për të reduktuar gabimet manuale duke përdorur zgjidhjen Uniflow të Canon.
- Zgjidhje të Integruara për Produktivitet Maksimal: Përfitoni nga mjetet tona të bashkëpunimit, të mbështetura nga ekspertiza e Canon, për të rritur produktivitetin dhe për të siguruar që dokumentet tuaja dixhitale dhe fizike të funksionojnë së bashku në mënyrë të përsosur.





Rrjeti



Si distributor i TP-Link, Albamedia Shpk bën shpërndarjen e produkteve dhe zgjidhjeve të avancuara të rrjetit, duke siguruar që partnerët dhe furnizuesit e shërbimeve të internetit (ISP) të përfitojnë nga zgjidhje efektive, konkurruese dhe të besueshme për nevojat e tyre.

Aginet, linjë e dedikuar për ISP nga TP-Link, është e përkushtuar në ofrimin e produkteve për zgjidhje të shpejta dhe shërbime të pa krahasueshme. Nëpërmjet Aginet, Albamedia ofron performancën më të mirë për çdo buxhet me një gamë të gjerë të produkteve për internet të shpejtë dhe mbulim Wi-Fi në të gjitha ambientet.



POS & Auto Id

UROVO

brother.
at your side

POSBANK

Honeywell

Newland

DASCOM

ZEBRA

Duke bashkëpunuar me markat lider të industrisë si Urovo, Brother, Zebra, Honeywell, Posbank, Newland, Dascom etj, Albamedia Shpk ofron pajisje dhe zgjidhje inovative për Pikat e Shitjes (POS) dhe Identifikimin Automatik (Auto ID) si smart data terminals, smart payment terminals, printerë termik për fatura, etiketa, skanerë barkodësh, pajisje all in one për pikat e shitjes, sisteme menaxhimi inventari dhe më shumë. Duke përdorur produkte të tilla, klientët mund të përmirësojnë menaxhimin e transaksioneve, inventarit, dërgesave dhe rritjen e efikasitetit, duke i ndihmuar ata të optimizojnë operacionet e tyre dhe të përmirësojnë përvojën e klientit.



Software

PICUS

Microsoft

vmware

tenable

kaspersky

TREND

panda

FORTINET

Adobe

Albamedia Shpk nëpërmjet partneritetit strategjik me Tenable, Picus security, Microsoft VMWare, Kaspersky, TrendMicro, Panda, Fortinet, dhe Adobe plotëson ofertat e saj me software të avancuar dhe zgjidhje të avancuara të sigurisë së IT-së që variojnë nga mbrojtja kibernetike në software krijues, dhe që i përgjigjen nevojave në rritje të bizneseve.



Monitorë & Zgjidhje Montimi

AOC


Neomounts

gembird

PHILIPS

HANNSpree

Si distributor i Philips, AOC, Hannspree, Neomounts, dhe Gembird, Albamedia Shpk ofron një gamë të gjerë monitorësh dhe zgjidhjeve të montimit. Kjo përzgjedhje plotëson nevoja të ndryshme si për konsumatorët privat ashtu dhe biznesin, duke ofruar teknologji të shkëlqyeshme përkrah opsioneve të larmishme të montimit për të krijuar hapësira pune të përshtatshme dhe efikase.





Pajisje për Data Storage

Kingston SanDisk

Në saj të partneritetit me markat e njohura Sandisk dhe Kingston, Albamedia Shpk ka një portofol të pasur të produkteve për ruajtjen dhe procesimin e të dhënave si RAM, SSD, HDD, karta memorije, USB flash drives, etj.



Komponentë Kompjuterik

UGREEN PHILIPS AOC gembird
maxell cablexpert energenie


Albamedia, në bashkëpunim me marka të njohura si Ugreen, Gembird, Maxell, Cableexpert dhe Energenie, ka diversifikuar ofertën e saj për klientët duke përfshirë një përzgjedhje të gjerë të komponentëve & aksesorëve të IT-së si mouse, tastierë, kabuj të ndryshëm dhe adaptor, pajisje audio dhe video, orët inteligjente, bateri etj.





Pajisje Zyre

Në Albamedia, ne ofrojmë një gamë të gjerë të konsumueshmeve dhe baterive për të përmbushur nevojat e bizneseve të çdo madhësie. Në partneritet me furnizues të besueshëm ne ofrojmë zgjidhje të cilësisë së lartë për printim dhe ruajtje energjie. Portofoli ynë përfshin tonerë, bojëra printeri, bateri për pajisje të ndryshme, dhe aksesore të tjerë thelbësorë që ndihmojnë në mbajtjen e pajisjeve tuaja të funksionojnë në mënyrë të pandërprerë dhe efikase. Cilësia dhe performanca e produkteve tona sigurojnë një rezultat të qëndrueshëm dhe të besueshëm, duke përmbushur standardet më të larta të industrisë.



Pajisje Smart



Albamedia ofron një gamë të gjerë shërbimesh dhe produktesh për krijimin e një shtëpie inteligjente që përmirëson komoditetin, sigurinë dhe efikasitetin e mjediseve shtëpiake. Ne ofrojmë zgjidhje të avancuara si: Kamera Sigurie Tapo dhe Vigi për mbikëqyrje të brendshme dhe të jashtme, pajisjet Kasa Smart për automatizimin e mjediseve të brendshme dhe të jashtme, Priza Inteligjente për kontrollin e pajisjeve shtëpiake nga distanca, Llama Inteligjente Wi-Fi për ndriçim të personalizuar, si dhe Hub dhe sensorë inteligjentë për monitorim dhe menaxhim të avancuar të shtëpisë tuaj.



albamedia

Delivering Technology To Your Business

Magazina Qëndrore
Rr. Rruga 3 Dëshmorët,
Tiranë, Shqipëri

Showroom dhe Zyrat
Rr. "Hiqmet Delvina" Nd. 4, H.1,
1022, Tiranë, Shqipëri.

Showroom dhe Zyrat
Gasper Karaçi 5, 10000
Prishtinë, Kosovë

 +355 4 2246026

 +355 69 20 96 147

 info@albamedia.al

 www.albamedia.al